



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. 96/2011

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtar Hajriz Hoti, e me procesmbajtës Naim Shala, në konfliktin administrativ të paditëses K. e S. "I." sh.a. nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson F.Z., kundër të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqësojnë A.Gj., R.A.dhe S.B., për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarve të palëve, me dt.04.11.2015, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses K. e S. "I." sh.a. nga P.. Anulohet vendimi e të paditurit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në Prishtinë, me nr.5/6 i dt.27.12.2010 dhe paditësja, lirohet nga sanksioni administrativ prej 100.000 € (njëqind mijë euro) i shqiptuar nga i padituri.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditëses F.Z., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë deklaramëve në seancat e kaluara. Me aktvendimin e gjykatës dt. 19.05.2015, është obliguar i padituri që përveç tjerash të ofroj edhe dëshmitë; mënyrën e sigurimit të marrëveshjes së dt.03.07.2009, marrëveshja e dt.03.07.2009, të sigurohet në origjinal. Me parashtresën e dt.11.08.2015, të pranuar nga gjykata në seancën e dt.16.10.2015, e cila ishte parashtruar nga i padituri, ky i fundit nuk ka ofruar provat e kërkuara si më lartë, për të cilat ka qenë i detyruar me aktvendim nga seanca e dt.19.05.2015. I padituri nuk ka ofruar prova për mënyrën e sigurimit të kopjes së "marrëveshjes" konform Ligjit për Procedurën Administrative. Gjithashtu i padituri nuk ka ofruar si provë marrëveshjen e dt.03.07.2009 në origjinal. Marrëveshja e ofruar në fotokopje si më heret, ashtu edhe tani në procedurën gjyqësore, nuk mund të konsiderohet provë relevante, nga se nuk është dokument zyrtar i lëshuar nga paditësja, meqë e njëjta nuk përmban nënshkrimin e personave zyrtar apo të autorizuar nga paditësja, nuk është e vulosur me vulën zyrtare të paditëses, vulën dhe nr. të protokolit, pasi e njëjta edhe nuk është e protokoluar në librin e protokolit të paditëses. Ndërsa siç cekem më lartë edhe origjinali i kësaj shkrese mungon, pra nuk mund të sigurohet dhe të prezantohet nga i padituri. Janë këto të gjitha mangësi, që në mungesë të këtyre elementeve një shkresë e tillë, nuk mund të quhet e as që e ka fuqinë e dokumentit zyrtar. Prandaj, paditësja edhe njëherë kërkon që të sigurohen provat e lartëcekura, në bazë të të cilave do të ishte dashtë që i padituri do ta kishte nxjerrë vendimin e atakuar, prova këto të cilat nuk kanë ekzistuar as në kohën e nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm. Duke pasur parasysh teknologjin dhe mundësië e manipulimit me dokumente, për këtë çështje gjykatës nuk i mjafton prezantimi i provës së fotokopjuar, pa ia prezantuar origjinalin prej nga është fotokopjuar edhe marrëveshja në fjalë. Gjithashtu gjatë administrimit të marrëveshjes nga Agjencia për Forenzikë, nuk është arritur të verifikohet autenticiteti, pasi që asnjëherë nuk është prezantuar në origjinal. Në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar nga arsyet e dhëna me lartë.

I autorizuari i të paditurit R.A., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetem në tërësi pranë përgjigjës në padi, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazur, si dhe mbeshtes raportin e ekspertizës së dt.30.07.2015, me nr.237/15-01, poashtu edhe parashtesën e dt.11.08.2015, me nr.245/15-04, si dhe deklaramet në seancat e mbajtura deri më tani. Edhe njëherë kërkoj nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ta refuzoj në tërësi si të pabazur.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.04.11.2015, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i të paditurit i dt.27.12.2010, konkluzioni i të paditurit i dt.24.01.2011, marrëveshja e dt.03.07.2009, parashtresa e BQK-së, e dt.10.06.2009, shikimi në rregullën 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë, të lëshuar nga B. dt.11.10.2008, kërkesa për rishqyrtim e të paditurës e dt.10.01.2011, vendimi i të paditurit i dt.23.03.2009, urdhëri i të paditurit i dt.27.03.2009, procesverbali i seancës dëgjimore i të paditurit, i dt.13.09.2010, parashtresa e paditëses e dt.29.05.2015, sqarimi i B., për tarifat e sigurimit të detyrueshëm për palët e treta, i dt.17.01.2011, kërkesa e të paditurit e dt.05.06.2015, përgjigja e paditëses e dt.10.06.2015, kërkesa e të paditurit drejtuar ATK e dt.15.05.2015, përgjigja e TRUSTIT e dt.22.05.2015, kërkesa e të paditurit e dt.18.06.2015, procesverbali i të paditurit i dt.18.06.2015, parashtresa e të paditurit e

dt.11.08.2015, kërkesa e të paditurit drejtuar Agjencisë së Forenzikës së Kosovës e dt.15.07.2015, komunikimi elektronik mes A.Gj. dhe Sh.E., R.A. etj. i dt.15.05.2015, përgjigja e ATK-së drejtuar të paditurit e dt.19.05.2015, përgjigja e Agjencisë së Regjistrimit Civil të dt.08.07.2015, ekspertiza e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë për të paditurin, e dt.29.07.2015, si dhe formulari për ekspërtim, lëshuar nga Laboratori i Forenzikës, nr.234/15-02, i dt.15.07.2015, si dhe nr.185/15-02.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, nenit 44.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e të paditurit të dt.27.12.2010, gjykata vëren se, i padituri ka marrë vendim me të cilin ka theksuar se “I. Vërtetohet se ekziston marrëveshja në mes të kompanive të sigurimit data 03.07.2009, e mbajtur në Gj. me të cilën janë fiksuar çmimet e policave të sigurimit dhe me këtë veprim i është pamundësuar klientit që të zgjedh kompaninë më të favorshme, njëherit është bërë kufizimi dhe çrregullimi i Konkurrencës në treg që bie ndesh me nenin 3 të Ligjit për Konkurrencën. II. Vërtetohet se, K.S. “D. (I.)” me nr. të regjistrimit ... adresa N. T. nr. ..., P., është nënshkruese e kësaj marrëveshje. III. Shqiptohet masa e sanksionit administrativ prej 100.000 euro (njëqindmijë euro), K.S. “D. (I.)” me nr. të regjistrimit ... adresa N. T. nr. ..., P., bazuar në nenin 35.1. germa (e) të Ligjit për Konkurrencën. IV. Shpallet e pa vlefshme e shfuqizuar dhe e pa zbatueshme Marrëveshja e dt.03.07.2009 e mbajtur në Gj., sipas nenit 35.1 germa b. të Ligjit për Konkurrencën”.

Paditësi i pakënaqur me të njëjtin vendim me dt.27.01.2011, ka ushtruar padi në këtë Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Pasi që kjo gjykatë lidhur me vendimin kontestues ka vendosur një herë duke anuluar vendimin e të paditurës, në të cilin vendim ishte e përfshirë edhe k. e s. K.S. “D. (I.)” dhe atë me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.183/11 të dt.16.07.2014, ndërsa gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së të paditurit, me aktgjykimin AA.nr.364/2014, të dt.21.10.2014, e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.183/11 të dt.16.07.2014 dhe lëndën me të gjitha shkresat e lëndës e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje, duke e udhëzuar gjykatën, që vet të vendos çështjen kontestuese duke theksuar se, “pasi që provat e palëve ndërgjyqëse kanë qenë në shqyrtim e që është dashur që të njëjtat të shtjellohen dhe shqyrtohen në mënyrë adekuate duke i ballafaquar palët me faktet e prezentuara të tyre se, kush e ka nënshkruar marrëveshjen në emër të KS, në këtë rast D., të identifikohet emër e mbiemër, a është i punësuar apo çfarë pozite ka në subjektin–kompaninë e sigurimit, në emër të kujt ka vepruar, a ka qenë i autorizuar, apo ka qenë përfaqësues i degës në Gj. etj”.

Kjo gjykatë duke iu referuar udhëzimeve të Gjykatës së Apelit të dhëna në aktgjykimin e lartëcituar në seancën e datës;19.05.2015, e ka detyruar të paditurin që gjykatës t’i ofroj dëshmi lidhur me mënyrën e sigurimit të marrëveshjes së dt.03.07.2009, e njëjta të sigurohet në original, kush e ka nënshkruar në emër të paditëses K.S. “D. (I.)”, të identifikohet me emër dhe mbiemër, a ka qenë i punësuar dhe ç’farë pozite ka pasur dhe në emër të kujt ka vepruar, a ka qenë i autorizuar, apo ka qenë përfaqësues i degës në Gj..

I padituri duke vepruar sipas kërkesës së gjykatës për sigurimin e provave me datë;11.08.2015, gjykatës ia sjellë parashtrësën, të cilës ia bashkangjet ekspertizën e Agjencisë së Forenzikës së Kosovës, me të cilën kjo Agjenci vërteton se këtu punëtori i paditësit B.B., është nënshkruar i marrëveshjes së datës;03.07.2009. Mirëpo i padituri nuk ka mundur me asnjë provë të vetme të provoj faktet tjera të kërkuara nga gjykata nga seanca e datës;19.05.2015.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson vendimi i kontestuar, është nxjerrë në kundërshtim me Ligjit për Procedurën Administrative. Përkatësisht nenin 84 par.2 të të njëjtit me të cilin është përcaktuar se, “se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar sipas vlerësimit të gjykatës është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës në mes dispozitivit dhe arsytimit të tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Derisa në dispozitivin e tij është theksuar se “Vërtetohet se ekziston marrëveshja në mes të kompanive të sigurimit e dt. 03.07.2009, e mbajtur në Gj., me të cilën janë fiksuar çmimet e policave të sigurimit dhe me këtë veprim i është pamundësuar klientit që të zgjedh kompaninë më të favorshme, njëherit është bërë kufizimi dhe çrregullimi i Konkurrencës në treg që bie ndesh me nenin 3 të Ligjit për Konkurrencën. II. Vërtetohet se, K.S. “D. (I.)”, me nr. të regjistrimit ... adresa N. T. nr. ..., P., është nënshkruese e kësaj marrëveshje. III. Shqiptohet masa e sanksionit administrativ prej 100.000 euro (njëqindmijë euro), K.S. “D. (I.)”, me nr. të regjistrimit ... adresa N. T. nr. ..., P., bazuar në nenin 35.1. germa e. të Ligjit për Konkurrencën. IV. Shpallet e pa vlefshme e shfuqizuar dhe e pa zbatueshme Marrëveshja e dt.03.07.2009, e mbajtur në Gj., sipas nenit 35.1 germa b. të Ligjit për Konkurrencën”. Ndërsa në arsyetimin e të njëjtit vendim, gjykata gjënë se nuk është provuar me asnjë provë, gjendja e konstatuar në dispozitivin e të njëjtit.

Në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura lidhur me këtë lëndë, i padituri e ka provuar të vetmin fakt se nënshkrues i marrëveshjes së dt.03.07.2009, ka qenë punëtori i paditëses, ndërsa fakte tjera të kërkuar nga gjykata, nuk ka mundur ti provojë më asnjë prove te vetme dëshmitë, siç janë; e njëjta të sigurohet në origjinal, se punëtori i paditëses a ka qenë i autorizuari për nënshkrimin e tillë, a ka qenë i autorizuari nga paditësja, apo ka qenë përfaqësues i degës në Gj.. Sipas vlerësimit të gjykatës për shqiptimin e një mase administrative ndëshkuese, vendimi duhet të bazohet në fakte juridike, të cilat sipas ligjit krijojnë gjendje juridike, mbi të cilën mund të bazohet norma konkrete juridike. Në rastin konkret i padituri në procedurën administrative dhe as në gjykatë, nuk ka mundur të provoj se, këtu paditësja është përgjegjëse lidhur me këtë çështje kontestuese.

Gjykata nuk është lëshuar fare në vlerësimin e kontratës së lartëcitur, pasi që i padituri nuk ka mundur të provoj në gjykatë, se e njëjta është nënshkruar nga personi i autorizuar i paditëses.

Mbi këto arsye gjykata vlerëson se vendimi kontestues, në bazë të provave vlerësuara me lartë, është i kundërligjshëm dhe paditësja lirohet nga masa e sanksionit administrativ prej 100.000 € (njëqindmijë euro), i shqiptuar nga i padituri.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2, lidhur me nenet 5, 6, dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.96/2011, dt.04.11.2015

Procesmbajtës
Naim Shala

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.